



PROCESVERBAL
I mbajtur PËR TAKIMIN E PARË PUBLIK
ME QYTETARËT E KOMUNËS SË DEÇANIT

Takimi publik është mbajtur me dt. **15 Korrik 2025(e Martë) në ora 10:00**

Vendi : Salla e Kuvendit në objektin e Komunës.

Në takim kanë marrë pjesë gjithsejt 80 pjesëmarrës (61 burra dhe 19 gra), Kryetari i Komunës, z.Bashkim Ramosaj, drejtor të drejtorive komunale (9), anëtarë të Kuvendit, Kryetar dhe anëtar të Këshillave Lokale të fshatrave dhe qytetarë të komunës së Deçanit.

Kryesues:z.Hajdar Sutaj.

Kryesuesi e ka hapë takimin e parë publik me qytetar me përshëndetje për të pranishmit, pastaj ka shtuar se këtu sot qytetar të nderuar do të debatojmë për çështjet që ju preokupojnë juve si qytetarë, për ofrimin e shërbimeve cilësore komunale dhe për çështjet lidhur më realizimin e synimeve programore të komunës së Deçanit, në gjashtë mujorin e parë të vitit 2025, në vazhdim fjalën ia ka dhënë Kryetarit të Komunës, Z.Bashkim Ramosaj.

Kryetari i Komunës, z.Bashkim Ramosaj, në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve ka prezantuar në pikë të shkurta punën e Ekzekutivit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025, ai ka thënë se buxheti komunal për vitin 2025 në total është 14,401,935.00 €, vetëm për investime kapitale 3,545,661.00€, me të cilat komuna ka investuar në projekte në vazhdim, të cilat disa kanë përfunduar ndërsa të tjerat janë duke u krye si dhe disa projekte janë të reja.

Kryetari në vazhdim ka njoftuar për ecurinë e punëve për çdo projekt.

Ali Sadikaj nga fshati Dashinoc, ka shtruar pyetjen, a do të kryhen sivjet rrugët e paasfaltuara.

Kryetari- përgjigjet se do të punojmë pa u ndalur por nuk mund të premtoj se do të kryhen të gjitha këtë vit.

Qazim Maloku nga fshati Dubravë, ka ngritë çështjen e problemit të fshatit me rrymë elektrike dhe ka kërkuar nga kryetari që këtë shqetësim mi adresua te KEDS-i, sepse që tri vjet janë qitë shtyllat por rrymë ende nuk ka.

Kryetari- përgjigjet se aty bëhet fjalë edhe për konteste pronësore dhe KEDS-i kërkon nga ne zgjidhjen e kontesteve, mirëpo asnjë komunë nuk ka përfitua ma shumë se ne në projekte të rrymës.

Agron Berisha, nga fshati Prapaqan, përgëzime kryetar për punët e kryera, pastaj ka shtruar këto pyetje: a parashihet rregullimi i shtratit të lumit Lumbardh i Deçanit më tutje, rregullimi i rrugës Deçan- Pozharë dhe kah po shkon shëndetësia sepse po mbyllen AMF-të.

Kryetari-shtrati i lumit Lumbardh është rregulluar nga Deçani deri te Verrat e Llukës, kurse nuk na kanë lejuar me punua në zonë të veçantë. Lumbardhi i Lloqanit ka me fillu mu punue prej fshatit Jasiq për shkak të vërshimeve atje. Rruga Deçan- Pozhar, kanë qenë 2 a 3 mendime të ndryshme për shkak të rrezikut të saj si rrugë e drejtë, shkolla e Lumbardhit do të bëhet vitin tjetër.

Drejtoresha e shëndetësisë, Agnesa Vokshi- ka sqaruar se një AMF sipas ligjit ofron shërbime deri 10.000 banorë, nëse nuk plotësohet numri banorëve humbet arsyeja e funksionimit të një AMF-je.

Avdullah Osaj nga Deçani-pyet, a ka mundësi me ba diçka për rregullim të dokumentacionit për Podin e Gështenjës, kurë do të kryhet kanali ujitjes në Deçan deri fund Deçanit .

Kryetari- problemi i Podit të Gështenjës për momentin nuk ka zgjidhje dhe çdo kush që është i lidhur me atë çështje duhet ti drejtohet gjykatës.

Drejtori i bujqësisë, Rifat Stojkaj, përgjigjet se jemi duke punuar me kompaninë "Lika" për hapje të kanaleve dhe me Hidrodrinin për pastrimin e kanaleve.

Gëzim Lika- falënderim kryetar për përkrahjen që ma keni bërë.

Ndriçim Çekaj, Irzniq-, Stadiumi në fshatin Irzniq ka dështuar,, mungesa e ujit të pijes, në KAB për tri vite vetëm 2 kanale janë parapa.

Drejtori i bujqësisë, Rifat Stojkaj-përgjigjet se fshati Irzniq janë krenaria jonë dhe në vazhdim ka cekë se komuna respektivisht drejtoria për BPZHR ka ndarë mjete bujqësore, lopë qumshtore dhe Serat.

Xx Dervishaj- thotë se vijat në fshatin Irzniq janë hapë por urat mbi to janë jo funksionale.

Beqir Kuçi Deçan- kërkon rregullimin e kanalit të ujitjes me beton në Topilla.

Kryesuesi i falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje dhe e shpalli mbledhjen të mbyllur.

Procesmbajtëse

Dyke Lolluni

